

KËRKESE PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Z./Znj. Alban Dafa		Data: 15/07/2022 Nënshkrimi: 
--	--	--

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

IDM Albania është duke kryer monitorimin e reformës në administratë publike në kuadër të projektit rajonal (për Ballkanin Perëndimor) WeBER 2.0, i financuar nga Komisioni Evropian. Ndër te tjera, ne jemi duke vlerësuar indikatorë lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore ku përfshihen të dhëna të përgjithshme dhe procedurat e konkurimit për shërbimin civil. Në këtë kuadër ne do të donim të merrnim informacion mbi të dhëna të shërbimit civil si më poshtë:

- 1- Sa ka qenë numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe sa prej tyre janë të plotësuar gjatë vitit 2021?

Përgjigje

Sikurse jeni në dijeni, Departamenti i Administratës Publike, në respektim të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” administron Regjistrin Qendror të Personelit. Ky regjistër është një bazë unike të dhënash shtetërore, ku ruhet e përpunohet elektronikisht informacioni për institucionin dhe burimet njerëzore aktive, për institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në çdo moment, institucionet e administratës shtetërore, në varësi të shkallës së aksesimit të RQP-së evidentojnë gjendjen aktuale lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore.

Ndërkohë, gjatë vitit 2021, janë emëruar në pozicione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, 857 nëpunës. Për informacione të mëtejshme mbi procedurat e rekrutimit në shërbimin civil të realizuara gjatë këtij viti, aksesoni raportin vjetor të DAP (Link: <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>).

- 2- Sa pozicione TND ka pasur në vitin 2021 dhe sa prej tyre kanë qenë të plotësuar?

Përgjigje

Në vitin 2021, sipas strukturave të institucioneve të administratës shtetërore, 101 pozicione të shërbimit civil kanë qenë pozicione TND, dhe kanë qenë të emëruar në pozicione të rregullta 72 nëpunës.

- 3- Sa prej pozicioneve të paplotësuar TND janë zëvendësuar përkohësisht nga nëpunës të tjerë civilë të emëruar në pozicione sipas përcaktimeve të Nenit 14 dhe Nenit 15 të Ligjit nr. 90/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore’?

Përgjigje

Departamenti i Administratës Publike, në respektim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe VKM –së Nr. 118, datë 5.3.2014, e ndryshuar, administron të dhëna lidhur me emërimet në pozicione të nivelit të lartë drejtues, të kryera në respektim të këtij kuadri ligjor dhe nuk prodhon akte administrative (emërime) dale në bazë dhe për zbatim të dispozitave të ligjit nr. 90/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore’.

Në çdo rast DAP, vijon me emërimin e një TND në një pozicion të rregullt të nivelit të lartë drejtues, në vijim të kërkesës së titullarit të institucioneve respektive, sipas parashikimeve të Kreut VI, pikat 3 dhe 4 të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar.

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Do të preferoja që informacioni të më dërgohej me email.

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/201__

Numri rendor i kërkesës:

Komente: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KËRKESE PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Z./Znj. Alban Dafa		Data: 15/07/2020 Nënshkrimi: 
--	--	--

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

IDM Albania është duke kryer monitorimin e reformës në administratë publike në kuadër të projektit rajonal (për Ballkanin Perëndimor) WeBER 2.0, i financuar nga Komisioni Evropian. Ndër te tjera, ne jemi duke vlerësuar indikatorë lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore ku përfshihen të dhëna të përgjithshme dhe procedurat e konkurimit të shërbimit civil. Në këtë kuadër, më poshtë kemi renditur katër pyetje, tre prej të cilave u referohen shpalljeve të konkurimeve të mëposhtme. Ndërkohë pyetja e fundit është e lidhur me arsyet e mundshme të anulimeve të konkurimeve në dy vitet e fundit.

a) Lista e shpalljeve të konkurimeve

Shpallja nr. 3477 - *Përgjegjës i Sektorit të Çertifikimit Fitosanitar dhe Monitorimit të PMB-ve, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Bimëve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve - Kategoria: III-a/1*

Shpallja nr. 3563 - *Inspektor në Sektorin e Licensimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Lundrimit Ajror, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror, në Autoritetin e Aviacionit Civil - kategoria: III-b*

Shpallja nr. 3490 - *Specialist në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit Ajror, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë - Kategoria: III-b*

Shpallje nr. 3588 - *Drejtor i Drejtorisë së Integritetit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes - kategoria: II-b*

Shpallje nr. 3752 - *Përgjegjës i Sektorit të Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Kulturën, në Ministrinë e Kulturës - kategoria: III-a*

b) Pyetjet

- 1- Gjatë procesit të konkurimit për shpalljet e mësipërme, a ka pasur ndonjë kërkesë për sqarim apo qartësim nga aplikantët? Nëse po cilat kanë qenë ato dhe si i jeni përgjigjur?
 - 2- Përveç dokumentacionit që kërkohet për t'u dorëzuar në fazën e parë të konkurimit, a ka pasur raste ku janë kërkuar dokumenta shtesë në fazat e mëtejshme të konkurimit?
 - 3- Në rast se një aplikant nuk e ka dorëzuar brenda afatit të paracaktuar dokumentacionin e kërkuar në funksion të shpalljeve të mësipërme, a janë skualifikuar menjëherë apo u është dhënë një kohë e caktuar për t'i plotësuar ato? Nëse nuk është dhënë një mundësi për të plotësuar dokumentat e kërkuara, a ka pasur raste kur aplikantët vetë kanë kërkuar shtyrje afati në mënyrë që t'i dorëzojnë ato në një kohë të dytë?
 - 4- Në raste anullimesh të konkurimeve të shpallura në dy vitet e fundit, cilat kanë qenë arsyet kryesore që çuan në anulimin e tyre? Nëse ka pasur anulime, a mund të specifikoni numrin/at e shpalljes/ve dhe mund të konfirmoni nëse arsyet janë publikuar në adresën e DAP-it?
-

Në vijim të kërkesës për informacion, lidhur me shpalljet me kod 3477, 3563, 3490, 3588, 3752 dhe për pyetjen mbi procedurat që janë anuluar gjatë dy viteve të fundit, DAP ju informon si mëposhtë vijon:

Pyetja 1

1. *Gjatë procesit të konkurrimit për shpalljet e mësipërme, a ka pasur ndonjë kërkesë apo qartësim nga aplikantët? Nëse po cilat kanë qenë ato dhe si i jeni përgjigjur?*

Gjatë procesit të konkurrimit për shpalljet 3477, 3563, 3490, 3572, nuk ka pasur asnjë kërkesë për sqarim apo qartësim nga aplikantët.

Pyetja 2

2. *Përveç dokumentacionit që kërkohet për t'u dorëzuar në fazën e parë të konkurrimit, a ka pasur raste ku janë kërkuar dokumenta shtesë në fazat e mëtejshme të konkurrimit?*

Referuar Vendimit nr.243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, shpallja e publikuar në faqen e Departamentit të Administratës Publike, përmban ndër të tjera, dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit,që aplikantët që aplikojnë duhet të dorëzojnë . Sqarojmë se, përveç dokumentacionit të kërkuar në shpallje, nuk kërkohet asnjë dokumentacion tjetër shtesë në fazat e mëtejshme të konkurrimit nga ana e DAP.

Pyetja 3

3. *Në rast se një aplikant nuk e ka dorëzuar brenda afatit të paracaktuar dokumentacionin e kërkuar në funksion të shpalljeve të mësipërme, a janë skualifikuar menjëherë apo u është dhënë një kohë e caktuar për t'i plotësuar ato? Nëse nuk ju është dhënë një mundësi për të plotësuar dokumentat e*

kërkuara, a ka pasur raste kur aplikantët vetë kanë kërkuar shtyrje afati në mënyrë që t'i dorëzojnë në një mënyrë të dytë?

Referuar Vendimit nr.243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, konkurrimi në shërbimin civil zhvillohet në dy faza:

a) Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

b) Vlerësimi i kandidatëve. Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, brenda afateve të përcaktuara bën verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kushtet dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse për arsyet e skualifikimit.

Legjislacioni i shërbimit civil parashikon afat ankimi për kandidatët e skualifikuar në fazën e verifikimit paraprak. Konkretisht, brenda 3 (tre) ose 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual (në varësi të llojit të procedurës së konkurrimit), kandidatët që nuk janë kualifikur kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim së bashku me dokumentacionin që ju mungon, pranë njësisë përgjegjëse. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në vlerësimin e kandidatëve, në rastin e procedurës së lëvizjes paralele përfshihen: a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 2 datë 27.03.2015 b) intervista e strukturuar me gojë, ndërkohë në rastin e pranimin nga jashtë shërbimit civil dhe ngritjes në detyrë, përfshihen :a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 2 datë 27.03.2015 b) vlerësimi me shkrim; c) intervista e strukturuar me gojë .Kandidatët kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda afateve të përcaktuara në VKM, pranë Komisionit përkatës, për secilën prej fazave të vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Për kodin : 3477- Nuk ka pasur ankesa;

Për kodin : 3563- ka pasur ankesa për fazën e verifikimit paraprak për mungesën e dokumentacionit. Kandidatët janë skualifikuar pasi nuk kanë ngarkuar diplomën e nivelit "Bachelor" apo të nivelit "Master Profesional" dhe janë njoftuar nga njësia përgjegjëse DAP për arsyen e skualifikimit. Kandidatët që brenda afatit të përcaktuar të ankimit kanë ngarkuar dokumentacionin e munguar, janë kualifikuar nga ana e njësisë përgjegjëse DAP dhe emrat e tyre janë shtuar në listën e verifikimit final.

Për kodin : 3490- ka pasur ankesa për fazën e verifikimit paraprak për mungesën e dokumentacionit. Kandidatët janë skualifikuar pasi nuk kanë ngarkuar librezën e punës, apo nuk plotësonin kriterin e kërkuar të përvojës dhe janë njoftuar nga njësia përgjegjëse DAP për arsyen e skualifikimit.

Për kodin : 3752 - ka pasur ankesa për fazën e verifikimit paraprak për mungesën e dokumentacionit. Kandidatët janë skualifikuar pasi nuk kanë ngarkuar vërtetimin e muajit të fundit të masës disiplinore ose për mungesën e vlerësimit në punë për 6-mujorin e fundit, i cili duhet të jetë "mirë" ose "shumë mirë";

4. Në rast anullimesh të konkurremeve të shpallura në dy vitet e fundit, cilat kanë qenë arsyet kryesore që çuan anullimin e tyre? Nëse ka pasur anullime, a mund të specifikoni numrin/ate shpalljeve dhe mund të konfirmoni nëse arsyet janë publikuar në adresën e DAP?

Në dy vitet e fundit është anuluar një procedurë konkurrimi (kod 3400) për shkak të të metave në procedurë, pasaktësisë në autorizimin e lëshuar nga përfaqësuesi i institucionit, anëtar i komisionit të vlerësimit. Lidhur me shpalljen sqarojmë se, në respektim të parashikimeve të legjislacionit të shërbimit civil, për institucionet e administratës shtetërore, shpallja e procedurës së konkurrimit për secilin pozicion publikohet, në faqen zyrtare të DAP-it dhe qëndron e publikuar, të paktën, deri në përfundimin e procedurës.

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Do të preferoja që informacioni të më dërgohej me email.

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/201__

Numri rendor i kërkesës:

Komente: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.